

# QENDRA KOMBËTARE E REHABILITIMIT TË TË VERBËRVE

## SHËRBIME DHE AKOMODIME

Shërbimet dhe akomodimet ofrohen përmes Qendrës Kombëtare të Rehabilitimit të të Verbërve, Vaqarr, bazuar në një përfitim direkt të personave të verbër dhe atyre me aftësi të tjera të kufizuara. Për qartësi dhe lehtësi përdorimi ato janë ndarë në katër kategori të ndryshme:

- Shërbime zhvillimore
- Akomodime në kompleks
- Akomodim hotelier
- Shërbime të tjera

### Shërbime zhvillimore

- Kurse formuese, rehabilituese, trajnuese
- Prioritete në hapjen e kurseve
- Veprimtari kulturore, sportive dhe argëtuese
- Akses në informacion
- Materiale në formate alternative

---

### Kurse formuese, rehabilituese, trajnuese

QKRV punon me programe instruktuese të përshtatura për personat e verbër në kuadër të proceseve formuese, rehabilituese dhe trajnuese për ta. Një larmi kursesh që nga mësimi i shkrimit Braille, gjuhës angleze të të gjitha niveleve, programeve bazë kompjuterike, fizioterapisë, menaxhimit të mirkoambjentit, zhvillimit të aftësive të jetesës së pavarur, orientimit dhe lëvizshmërisë, organizohen për grupe me nga 7-10 persona, në salla të adaptuara në përputhje me nevojat e kursantëve, me një seri politikash të strukturuar lidhur me pranimin e kursantëve, asistimin me mësues apo administrator të vecantë, organizimit të programeve të përmbledhura apo më të zgjeruara varësisht nga kërkesat që vlerësohen nga një komision i ngritur për këtë qëllim.

### Prioritete në hapjen e kurseve

Për të siguruar një akses të barabartë dhe të shpejtë në të gjitha programet e shërbimeve që ofrohen në kompleks, kurse dhe shërbime, mund të ofrohen dhe jashtë planeve të parashikuara varësisht nga vlerësimi i kërkesave të personave të verbër që kërkojnë të akomodohen.

## **Materiale në format alternative**

QKRV do t'u asistojë në prodhimin e librave dhe materialeve për frekuentimin e niveleve të ndryshme të shkollimit; për kurse të ndryshme me qëllim formime profesionale etj në format alternative. Mundësitë përfshijnë libra dhe materiale në format audio, libra elektronike, në Braille, softëare që mundësojnë aksesin në këto matëriale si Jaës, Screen reading; materiale në CD ose format MP3, dhe tekste me shkrim të zmadhuar. Gjithcka vjen nën logon prodhuese të studios moderne të QKRV, të vetmes në Shqipëri me kapacitete të tilla prodhuese të matërialeve në brail, të studios së prodhimit të librave në audio dhe kabinetit tifloteknik të pajisur me një larmi instrumentash tifloteknikë.



## **Akomodimet në kompleks**

- **Lëvizshmëri dhe orientim në mjedise të sigurta**
- **Teknologji e përshtatur, Pajisje ndihmëse**
- **Mjedise sportive dhe sociale**
- **Parkim**
- **Shërbim me autobus**

### **Lëvizshmëri dhe orientim në mjedise të sigurta**

QKRV në kompleksin e saj ka përfshirë teknikat dhe materialet e arredimit të brendshëm në përputhje me standartet ndërkombëtare për personat e verbër duke krijuar mjedise plotësisht të aksesueshme përmes sinjaleve taktike nëpër dysheme, rampave hyrëse dhe në katin e parë, hartave të kateve përkatëse në relief, shenjave konvencionale dhe në Braille lehtësisht të identifikueshme për cdo sallë, duke e bërë të arritshëm cdo kënd të kompleksit nga personat e verbër në mënyrë të pavarur .

### **Teknologji e përshtatur, Pajisje ndihmëse**

Për personat e verbër që akomodohen në kompleks bëhet një vlerësim i nevojave për pajisje speciale që lidhen me lëvizshmërinë, teknologji adaptive, pajisje speciale, që lehtësojnë pjesëmarrjen e tyre në shërbime të ndryshme që ofrohen në kompleks si ato, të formimit profesional, kulturore sportive etj. Pajisjet dhe teknologjite ndihmëse përfshijnë një seri katëgorish që mund të gjenden në katalogun e pajisjeve tifloteknike.

### **Mjedise Sportive**

Fushë minifutbolli kalceto e disenjuar dhe e përshtatur me standartet më të mira ndërkombëtare për këto mjedise sportive, e gatshme për organizimin e aktiviteteve të ndryshme sportive si, futboll, golball etj. 3 salla për organizim konferencash, takimesh, etj me një kapacitet total prej **vendesh** janë në shërbim të qytetarëve të verbër dhe jo vetëm.

## Parkim




Kompleksi ofron një parkim të jashtëm prej \_\_\_\_\_ vendesh për automjete për personat që do të akomodohen në të gjatë aktiviteteve të ndryshme , kurseve etj.

## Shërbime me autobus

QKRV ofron itinerare udhëtimi me minibus nga qendra e Tiranës në QKRV dhe anasjelltas që lehtësojnë transportin për PAK që do të akomodohen në qendër. Gjithashtu ky shërbim mund tu vihent në dispozicion grupeve të ndryshme të PAK që shprehin dëshirën për ture të ndryshme brenda vendin me një cmim shumë të arsyeshëm.



## Akomodim në hotel

-  Shërbimi hotelier
-  Shërbimi i kafeterisë
-  Shërbimi i mensës

## Shërbimi hotelier

QKRV ofron një akomodim hotelier prej 45 dhomash, \_\_\_\_\_ dhoma dopjo; \_\_\_\_\_ dhoma teke. Akomodimi përfshin sigurimin e një dhome teke apo dopjo, apo me ndarje, me kushte bazike të nevojshme për qëndrim të përkohshëm të personave që do të akomodohen në kompleks. Akomodimi përfshin të gjitha facilitetet për banjot, dushet dhe aksesoret e tjerë, sinjale taktike të emergjencave dhe të orientimit, si dhe shërbimin e stafit mikpritës për të krijuar të gjitha lehtësitë e nevojshme për ta bërë akomodimin sa më mikpritës dhe të këndshëm. Cdo akomodim ka të përfshirë brenda cmimit simbolik dhe mengjesin falas pranë mensës së kompleksit.

## Shërbimi i kafeterisë

QKRV mund të ofrojë shërbime bar- kafe për një numër total prej \_\_\_\_\_ personash të akomoduar në qendër. Stafit mikpritës që mbulon këto shërbime kujdeset në detaj për përmbushjen e kërkesave të të akomoduarve për të krijuar një mjedis sa më relaksues

## Shërbimi i mensës

Nga shërbimi i mensës, mund të përfitojnë cdo ditë një numër total prej \_\_\_\_\_ personash të akomoduar në kompleks. Vaktet e shërbyera realizohen nëpërmjet shërbimit të brendshëm në kuzhinën e mensës me një hapësirë prej \_\_\_\_\_ m2 si dhe përmes shërbimit catering në raste të vecanta. Planifikimi i ofrimit të shërbimit të mensës brenda kompleksit ku ofrohen shërbimet e ndryshme sociale, synon krijimin e një modeli të ri marrëdhëniesh të ndersjella mes përfituesve të akomoduar dhe ofruesve të shërbimeve si pjesë e stafit të kompleksit. Ky shërbim i ri

gjithashtu, vjen si rezultat i planifikimit shumëdimensional të shërbimeve që ofron kompleksi dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre.



### **Shërbime të tjera**

QKRV ofron dhe një seri shërbimesh që tjera që nuk lidhen domosdoshmërisht me ato të përmendura më lart:

### **Këshillim për karrierën**

QKRV ka një staf të specializuar në dispozicion për të ndihmuar nxënësit, të rinjtë dhe familjarët e personave të verbër në të kuptuarit se si aftësia e kufizuar, dëmtimet e shikimit, verbëria, mund të ndikojnë në drejtimin edukativ e planet për karrierën tek ta si dhe ofrimin e këshillave profesionale për këtë qëllim.

### **Advokim**

QKRV punon në mënyrë direkte me personat e verbër për të avokuar për trajtim të barabartë dhe të drejtë të tyre në të gjitha fushat si arsimim, përfaqësim, punësim, strehim, çështje civile etj.